

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN GOLEM, KAVAJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Golem, Kavajë, me objekt: :
““Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë së komunës, etj.” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.24 , datë 27. 02.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 379/5, datë 27.02.2012, dërguar z. **Agron Agalliu**, Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të përfshihen në programimin e shpenzimeve të vitit pasardhës, detyrimet afat shkurtër ndaj të tretëve të rezultuara nga mbyllja e vitit ushtrimor, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit 2011”, pika 97, ku përcakton se “....., më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj miratohen fondet për të financuar veprimtarin e vitit në vazhdim”.

Deri në mars 2012

2. Të krijohen kushte për mbajtjen e kontabilitetit në format elektronik me program finance.

Gjatë vitit 2012

3. Të shmangen veprimet ekstra kontabile, në hartimin e bilancit vjetor. Tepricat e llogarive, të pasqyrohen në bilanc, nga të dhënat e bartësve kontabël dhe jo vetëm nga të dhënat e situacionit të rakorduar me degën e thesarit,”Për shpenzimet dhe të ardhurat”, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile.

Në mbylljen e bilancit v. 2011

4. Të merren masa për tu pajisur me aparate matës për energjinë elektrike. Të mos pranohet likuidimi i faturave të energjisë elektrike, të cilat nuk përmbajnë të dhënat e lexuara në aparatet matës të instaluar për këtë qëllim, në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ku në mënyrë eksplicite citohet se energjia elektrike e përdorur nga klienti, matet dhe faturohet nga furnizuesi, sipas regjistrimeve të aparateve matëse. Instalimi, mirëmbajtja dhe verifikimi i saktësisë së matësit bëhen nga furnizuesi me shpenzimet e veta.

Menjëherë

5. Të respektohet nga zyra e financës, numri me rend rritës i urdhër shpenzimit, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ dhe VKM nr. nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile.

Vazhdimisht

6. Të rakordohen llogaritë sintetike me ato analitike dhe të azhurnohen artikujt kontabël si llogaria nr. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”, artikujt kontabël për operacionet me shtetin debitorë e kreditorë. Llogaritë inventariale të mos mbahen në grup me emërtimin “Magazina”, por të mbahen sipas emërtimeve të llogarive, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14, datë, 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre”.

Gjatë vitit 2012

7. Të bëhet rillogaritja e vlerës limit të kontratës, bazuar në çmimet e zërave të punimeve të përcaktuara në buletinin e çmimeve të botuar nga INSTAT, të përcaktuara nga studimi i çmimeve të tregut, të përcaktuara në çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë autoriteti kontraktor apo nga autoritete të tjera kontraktore dhe të përcaktuara nga çmime ndërkombëtare të botuara, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për Rregullat e Prokurimit Publik” me ndryshime.

Vazhdimisht

8. Nga njësia e prokurimit të përfshihet grafiku i zbatimit të punimeve si pjesë përbërëse e dokumentacionit standard të procedurës së prokurimit, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për Rregullat e Prokurimit Publik” me ndryshime.

Vazhdimisht

9. Nga njësia e prokurimit të mbahet procesverbal i miratimit të dokumentacionit standard të procedurës së prokurimit dhe të pasqyrohen në të ndryshimet të argumentuara krahasimisht me procesverbalin e hartimit të dokumentacionit standard të procedurës së prokurimit, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për Rregullat e Prokurimit Publik” me ndryshime.

Vazhdimisht

10. Në ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomik duhet të përcaktohen zërat e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryej secili nga anëtarët e grupimit, bazuar në raportin e vendosur në momentin e bashkimit të operatorëve ekonomik, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për Rregullat e Prokurimit Publik” me ndryshime.

Vazhdimisht

11. Të dërgohet regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik çdo 4 muaj, në Agjencinë e Prokurimit Publik, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për Rregullat e Prokurimit Publik” me ndryshime.

Menjëherë

12. Të dhënat e regjistrimit zyrtar të objekteve të taksueshme në fshatrat turistike të krijuara nga të dhënat e terrenit, të rakordohen me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, për të përcaktuar pronësinë mbi objektet, për të cilat do të aplikohen taksa, duke shmangur influencën negative në grumbullimin e të ardhurave, në zbatim të ligjit nr. 10186, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, i ndryshuar.

Menjëherë

13. Të evidentohen dhe të regjistrohen me të dhëna të plota trojet shtetërore. Të rakordohet me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, për saktësimin e aseteve pronë e Komunës Golem ose pronë shtet, në zbatim Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendorë e Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 ”Për mënyrën e paraqitjes nga njësit e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”, si dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes Vendore”.

Menjëherë

14. Në objektet ndërtimore, për të cilat, lëshohet leja e shfrytëzimit, akti i kolaudimit të rrjetit të ujësjellësit të shoqërohet me projektin e kanalizimeve të ujësjellësit dhe akti i kolaudimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza të shoqërohet me projektin e KUZ-ve, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Vazhdimisht

15. Gjatë ushtrimit të detyrave funksionale INU të ushtrij kontrole në lidhje me vendosjen e mbikëqyrësve të punimeve të ndërtimit, të ushtrij kontrole në lidhje me fillimin e punimeve nga subjektet ndërtuese, të kërkoj dhe detyroj zbatuesit e punimeve të njoftojnë zyrtarisht fillimin e punimeve, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Vazhdimisht

16. INU dhe zyra e Urbanistikës në Komunë, të ushtroj kontrole në objektet ndërtimore, për ndryshime të elementeve arkitektonik dhe zëra punimesh të pa kryera, krahasimisht me projektet e plota të zbatimit të objektit, para lëshimit të lejes së shfrytëzimit, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Vazhdimisht

17. Firmave të ndërtimit, tu kërkohet nga INU në Komunë, plani i organizimit të punimeve në objekt, mbajtja e procesverbalit për gjendjen e masave të sigurimit teknik të punimeve të ndërtimit dhe pajisja me mjete për mbrojtjen e jetës së punëtorëve, si pjesë e dokumentacionit të dosjes teknike, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve” i ndryshuar.

Vazhdimisht

18. Dokumentacioni standard i procedurës së prokurimit të ruhet në dosjen e tenderit dhe të mos mjaftohet vetëm me ruajtjen në format elektronik, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20/11/1996 “Për prokurimin publik” me ndryshime dhe të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për Rregullat e Prokurimit Publik” me ndryshime.

Vazhdimisht

19. Zyra e Urbanistikës dhe Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik të Komunës, të saktësojnë dhe rakordojnë sipërfaqen ndërtimore, të objektit ndërtimor “strukturë turistike 4 kat + papafingo + bodrum” e miratuar me lejen e ndërtimit nr. 4/17/2 datë 13.10.2005 dhe rimiratuar për ndryshim të subjektit ndërtues, nga subjekt ndërtues [REDAKTUAR], të subjekti ndërtues [REDAKTUAR] me vendim të KRRT nr. 1/ 16, datë 20.07.2007, në parcelën nr. 45, në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”.

Menjëherë

B. MASAT PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore *vlera 11,211,475 lekë* dëm shkaktuar buxhetit të Komunës, si më poshtë:

- Shuma 3,433,195 lekë nga investitori [REDAKTUAR] përfituar padrejtësisht, nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe taksës për financimin e studimeve urbanistike, në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

- Shuma 784,753 lekë nga investitori [REDAKTUAR] përfituar padrejtësisht nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe taksës për financimin e studimeve

urbanistike, në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

- Shuma 269,100 lekë nga shoqëria “██████████” përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve, në tenderin me objekt “Sistemim, asfaltim rruga hyrja e shkollës së mesme -xhami - lagje Gezdaraj”, për punime të pakryera në zërat: - Shtrim me asfaltobeton.

- Shuma 144,450 lekë nga shoqëria ██████████ përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve, në tenderin me objekt “Sistemim çakull i rrugës Tilaj –Varreza”, për punime të pakryera në zërat: ndërtim bankine, beton M-200 për kanale dhe mure.

- Shuma 585,530 lekë nga shoqëria ██████████ përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve, në tenderin me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugës unazë Kërçukë dhe shtrim me çakull i vazhdimit të rrugës Kërçukë fshat”, për punime të pakryera në zërat: gjërmim dheu seksion i detyruar, mbushje me çakull gurore, spërkatje me prajmer.

- Shuma 1,726,607 lekë nga shoqëria ██████████ përfituar padrejtësisht në tenderat si më poshtë:

i. 315,527 lekë në tenderin me objekt “Sistemim me çakull i rrugës Kanaparaj –Pularia Aganas”, për punime të pakryera në zërat: - Gjërmim dheu seksioni lirë, - Shtresë çakulli 30 cm, - Shtresë stabilizanti 10 cm.

ii. 1,411,080 lekë në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i degëzimeve Nr1/1,1/2,1/3,1/4,1/5, rrugë paralele si dhe rruga nr. 1 gjithsej 778 ml dhe gjerësi 3-4 ml”, për punime të pakryera në zërat: - Spërkatje me prajmer, - Shtresë asfaltobeton 4 cm, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve.

- Shuma **1,632,125 lekë** nga shoqëria ██████████ përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve, në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Aganas Stalla Pularia”, për punime të pakryera në zërat:

- Shtresë çakulli 15 cm, - Shtresë binderi, shtresë asfalti, shtresë fileri, spërkatje me bitum.

- Shuma **2,043,250 lekë** nga ██████████ përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve, në tenderin me objekt “Sistemim çakull i rrugës Golem Aganas”, për punime të pakryera në zërat: shtresë çakulli guri tr. 20 cm l=1200, shtresë fileri, FV tombino 400.

- Shuma **592,465 lekë** nga shoqëria “Senka” shpk, përfituar padrejtësisht në tenderat si më poshtë:

i. 209,525 lekë në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës nga asfalti Kanaparaj shkolla 9 vjeçare”, për punime të pakryera në zërat: spërkatje me bitum, shtresë stabilizanti 10 cm, shtresë çakulli.

ii. 282,500 lekë në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim unaza e re Golem deri në Kryemëdhenj”, për punime të pakryera në zërat: mbushje me cakull 10 cm, spërkatje me prajmer.

iii. 100,440 lekë në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Zikxhafaj deri në Varreza”, për punime të pakryera në zërat: germim dheu prog 289-370, germim dheu prog 420-480, shtresë çakulli, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve.

C. MASAT ADMINISTRATIVE

1. Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, nenet 15 e 16, Komuna Golem Kavajë, të kërkojë nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik pranë tij:

- të gjobisë zbatuesit e punimeve të ndërtimit si më poshtë:

1. Shoqërinë e ndërtimit [REDAKTUAR] në cilësinë e zbatuesit të punimeve, në objektin struktura turistike 5 kat + papafingo, gjobë në masën 500,000 lekë, për zëra të punimeve të pa kryera krahasimisht me projektet e plota të zbatim, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me pikën 7, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikën 1/4, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me vendimin e KRRT nr. 4/23/2, datë 13.10.2005 ”Për miratimin e lejes së ndërtimit”.

2. Shoqërinë e ndërtimit [REDAKTUAR] në cilësinë e zbatuesit të punimeve, në objektin struktura turistike 4 dhe 5 kat dhe objektin kompleks turistik 4 kat dhe 1 kat bodrum, gjobë në masën 1,000,000 lekë, për punime të pa kryera krahasimisht me projektet e plota të zbatim, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me pikën 7, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikën 1/4, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me vendimin nr. 2/39, datë 16.06.2005 të KRRT ”Për miratimin e lejes së ndërtimit” dhe me vendimin e KRRT nr. 2/39/1, datë 16.06.2005 ”Për miratimin e lejes së ndërtimit”.

3. Shoqërinë e ndërtimit [REDAKTUAR] në cilësinë e zbatuesit të punimeve, në objektin “struktura turistike 5 kat + papafingo, gjobë në masën 500,000 lekë, për punime të pa kryera krahasimisht me projektet e plota të zbatim, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me pikën 7, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikën 1/4, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me vendimin e KRRT nr. 4/51, datë 16.08.2004 ”Për miratimin e lejes së ndërtimit”.

4. Shoqërinë e ndërtimit [REDACTED] në cilësinë e zbatuesit të punimeve, në objektin ndërtimor, dy struktura turistike 4 kat + shërbime + n/çati, gjobë në masën 500,000 lekë, për punime të pa kryera krahasimisht me projektet e plota të zbatim, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me pikën 7, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikën 1/4, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me vendimin e KRRT nr. 2/21/1, datë 16.06.2005”Për miratimin e lejes së ndërtimit”.

5. Shoqërinë e ndërtimit [REDACTED] në cilësinë e zbatuesit të punimeve, në objektin ndërtimor, 5 struktura turistike 4 kat + papafingo, gjobë në masën 500,000 lekë, për punime të pa kryera krahasimisht me projektet e plota të zbatim, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me pikën 7, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikën 1/4, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me vendimin e KRRT nr. 4/12/2, datë 13.10.2005 ”Për miratimin e lejes së ndërtimit”.

6. Shoqërinë e ndërtimit [REDACTED] në cilësinë e zbatuesit të punimeve, në objektin ndërtimor, banesë + shërbime + garazh + papafingo 4 kat, gjobë në masën **500,000 lekë**, për punimeve të pa kryera krahasimisht me projektet e plota të zbatim, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me pikën 7, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikën 1/4, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me vendimin e KRRT nr. 2/21, datë 28.03.2008 ”Për miratimin e lejes së ndërtimit”.

- të gjobisë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve të ndërtimit si më poshtë:

1. [REDACTED] në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, në objektin “Sistemim, asfaltim i rrugës unaza Kërçukë dhe shtrim me çakull i vazhdimit të rrugës Kërçukë fshat”, gjobë në masën 50,000 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 585 530 lekë, duke shkelur nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 2, datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

2. [REDACTED] në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, në objektin “Sistemim me çakull i rrugës Kanaparaj –Pularia Aganas”, gjobë në masën 50,000 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 315 527 lekë, duke shkelur nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 2, datë 13.05.2005,“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

3. [REDACTED], në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, në objektin “Sistemim asfaltim i rrugës Aganas Stalla Pularia”, gjobë në masën 50,000 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 1 632 125 lekë, duke shkelur nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

4. [REDACTED] në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, në objektin “Sistemim asfaltim i degëzimeve Nr1/1,1/2,1/3,1/4,1/5, rrugë paralele si dhe rruga nr. 1 gjithsej 778 ml dhe

gjerësi 3-4 ml”, gjobë në masën 50,000 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 1 411 080 lekë, duke shkelur nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

5. ████████ në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, në objektin “Sistemim çakull i rrugës Golem Aganas”, gjobë në masën 50,000 lekë për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 2 043 250 lekë, duke shkelur nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

6. ████████ në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, në objektin “Sistemim asfaltim i rrugës Aganas Stalla Pularia”, gjobë në masën 500,000 lekë për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 1 632 125 lekë, duke shkelur nenin 12, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

7. ████████, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, në objektin “Sistemim asfaltim i degëzimeve Nr1/1,1/2,1/3,1/4,1/5, rrugë paralele si dhe rruga nr. 1 gjithsej 778 ml dhe gjerësi 3-4 ml”, gjobë në masën 500,000 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 1 411 080 lekë, duke shkelur nenin 12, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

2. Në mbështetje të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 54, Komuna Golem Kavajë, të kërkojë nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik pranë tij:
- të gjobisë subjektet private në cilësinë e investitorit të objekteve, si më poshtë:

1. Subjektit privat në cilësinë e investitorit, për objektin ndërtimor, “tre struktura turistike 3 kat + garazh + papafingo”, gjobë në masën **1,664,160 lekë**, për sipërfaqe objekti të zmadhuar, jashtë kushteve të projektit të miratuar në lejen e ndërtimit, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, pikën 7, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikën 1/4, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me vendimin e KRRT nr. 2/61, datë 16.06.2005, “Për miratimin e lejes së ndërtimit”.

2. Subjektit privat në cilësinë e investitorit, për objektin ndërtimor, “struktura turistike 5 kat”, gjobë në masën **7,728,708 lekë**, për sipërfaqe objekti të zmadhuar, jashtë kushteve të projektit të miratuar në lejen e ndërtimit, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, pikën 7, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikën 1/4, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me vendimin e KRRT nr. 1/16, datë 08.03.2005 “Për miratimin e lejes së ndërtimit”, trajtuar në faqen 45 të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Gjergji Dhima, Pal Daçi, Kujtim Rama dhe Tatjana Shurbi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT